

Hepatiti Viral B

Cfarë është hepatiti viral B?

Hepatiti viral B është një infeksion i mëlçisë potencialisht kërcënues për jetën, që shkaktohet nga virusi i hepatitit B. Ai përbën një problem shëndetësor madhor dhe global. Mund të shkaktojë sëmundje kronike të mëlçisë, dhe vë njerëzit në rrezik të lartë vdekjeje nga kanceri i mëlçisë dhe cirroza. Kanceri i mëlçisë është pothuajse gjithmonë fatal, dhe shpesh zhvillohet te persona në moshën më produktive.

Si transmetohet hepatiti viral B?

Virusi i hepatitit B mund të mbijetojë jashtë trupit për të paktën 7 ditë. Gjatë kësaj kohe, virusi mund të shkaktojë infeksion nëse ai hyn në trupin e një personi i cili nuk është i mbrojtur nga vaksina. Periudha e inkubacionit të virusit të hepatitit B është mesatarisht 75 ditë, por mund të ndryshojë nga 30 në 180 ditë. Virus mund të zbulohet brenda 30 deri në 60 ditë pas infektimit, dhe mund të persistojë e të zhvillojë hepatitin kronik B.

Në shumë zona me përhapje të gjerë, hepatiti B zakonisht përhapet nga nëna tek fëmija gjatë lindjes, ose gjatë ekspozimit ndaj gjakut të infektuar, sidomos nga një fëmijë i infektuar tek një fëmijë i painfektuar, gjatë 5 viteve të para të jetës.

Hepatiti B përhapet edhe nga ekspozimi i lëkurës ose mukozave me gjakun e infektuar apo me lëngje të tjera të trupit (si lëngjet vaginale, menstruale, sperma) të një personi të infektuar.

Transmetimi seksual i hepatitit B mund të ndodhë sidomos te meshkujt e pavaksinuar që kryejnë seks me meshkuj, te personat heteroseksualë që kanë shumë partnerë seksualë, ose prej kontaktit me punonjësit e seksit. Infeksioni në moshë madhore çon në hepatit kronik në rreth 5% të rasteve. Transmetimi i virusit mund të ndodhë edhe nëpërmjet ripërdorimit të ageve e shiringave në mjediset e kujdesit shëndetësor, ose te personat që injektojnë drogë. Përveç kësaj, infeksioni mund ndodhë gjatë procedurave mjekësore, kirurgjike dhe dentare, bërjes së tatuazheve, ose nëpërmjet përdorimit të makinave të rrojes dhe objekteve të ngjashme që janë të ndotura me gjak të infektuar.

Cilat janë shenjat e hepatitit viral B?

Shumica e njerëzve nuk përjetojnë asnjë shenjë gjatë fazës akute të infeksionit. Megjithatë, disa njerëz shfaqin shenja që zgjasin disa javë duke përfshirë zverdhje të lëkurës dhe syve, urinë të errët, lodhje ekstreme, të përziera, të vjella dhe dhimbje barku. Një pjesë e personave me hepatit mund të zhvillojnë dëmtim akut të mëlçisë që mund të çojë në vdekje. Te disa njerëz, virusi i hepatitit B mund të shkaktojë infeksion kronik të mëlçisë, që më vonë mund të kalojë në cirrozë dhe kancer të mëlçisë. Mbi 90% e të rriturve të cilët janë të infektuar me virusin e hepatitit B por që nuk kanë komplikacione, do të shërohen natyrshëm nga virusi brenda vitit të parë.

Gjasat që infeksioni me virusin e hepatitit B të bëhet kronik varet nga moshë në të cilën një person infektohet. Më pak se 5% e personave që infektohen kur janë të rritur do të zhvillojnë infeksion kronik; rreth 20-30% e të rriturve me infeksion kronik do të zhvillojnë cirrozë dhe/ose kancer të mëlçisë.

Si vendoset diagnoza e hepatitit viral B?

Klinikisht nuk mund të diferencohet hepatiti B nga hepatiti i shkaktuar nga agjentë të tjerë viralë; për këtë arsye konfirmimi laboratorik i diagnozës është thelbësor. Një numër testesh gjaku janë në dispozicion për të diagnostikuar njerëzit me hepatit B. Ato mund të përdoren edhe për të dalluar infeksionet akute e kronike. Diagnoza laboratorike e infeksionit të hepatitit B fokusohet në zbulimin e antigjenit të virusit të hepatitit B-HBsAg. OBSH-ja rekomandon që të gjitha dhurimet e gjakut të testohen për hepatit B, për të garantuar sigurinë e gjakut e për të shmangur transmetimin aksidental për njerëzit që marrin produktet e tij. Infeksioni kronik karakterizohet nga prania e HBsAg për të paktën 6 muaj. Prezenca e HBsAg për të paktën 6 muaj është tregues kryesor i rrezikut për zhvillimin më vonë të hepatitit kronik, cirrozës dhe kancerit të mëlçisë. Ende ka qasje të kufizuara në diagnozën dhe trajtimin e hepatitit B në shumë vende me burime të kufizuara. Shumë njerëz janë diagnostikuar vetëm kur ata tashmë kanë sëmundje të mëlçisë të avancuar.

Si trajtohet hepatiti viral B?

Nuk ka trajtim specifik për hepatitin akut B. Ndërsa hepatiti kronik B mund të trajtohet me medikamente. Trajtimi mund të ngadalësojë përparimin e cirrozës së mëlçisë, të reduktojë incidencën e kancerit të mëlçisë dhe të përmirësojë mbijetesën afatgjatë. Në shumicën e njerëzve trajtimi nuk shëron infeksionin e hepatitit B, por vetëm pengon shtimin e virusit. Prandaj shumica e njerëzve që fillojnë trajtimin e hepatitit B duhet ta vazhdojnë atë gjithë jetën.

Transplantimi i mëlçisë nganjëherë përdoret te njerëzit me cirrozë në vendet me të ardhura të larta, me sukses të ndryshëm.

Si parandalohet hepatiti viral B?

Vaksina e hepatitit B është shtylla e parandalimit të hepatitit B, një vaksinë që është në dispozicion që prej vitit 1982. Vaksina është 95% e efektshme në parandalimin e infeksionit dhe pasojave kronike të tij, hepatitit kronik, cirrozës dhe kancerit të mëlçisë. OBSH-ja rekomandon që të gjithë fëmijët të marrin vaksinën e hepatitit B sa më shpejt të jetë e mundur pas lindjes, mundësisht brenda 24 orëve. Kjo dozë pasohet nga 2 ose 3 doza të tjera për të përfunduar gjithë skemën e vaksinimit.

Gjithashtu, duhet të vaksinohen edhe grupet e personave me rrezik të lartë që përfshijnë:

- Personat të cilët shpesh kanë nevojë për gjak apo produkte të tij, pacientët që bëjnë dializë dhe transplantim të organeve (OBSH-ja rekomandon që gjaku i dhuruar të testohet për hepatit B, për të shmangur transmetimin te njerëzit që marrin produkte gjaku).
- Të burgosurit.
- Personat që injektojnë drogë.
- Familjarët dhe partnerët seksualë të personave me infeksion kronik të hepatitit B.
- Personat me shumë partnerë seksualë.
- Punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe ata të cilët mund të jenë të ekspozuar ndaj gjakut dhe produkteve të tij gjatë punës së tyre.
- Udhëtarët që nuk kanë përfunduar skemën e tyre të vaksinimit të hepatitit B, të cilëve duhet t'u ofrohet vakcina para se të nisen në zonat endemike.

Përveç vaksinës e cila ka një siguri dhe efektivitet të lartë, zbatimi i strategjive të tjera të sigurisë së gjakut, duke përfshirë sigurimin e testimit të të gjithë gjakut të dhuruar dhe komponentëve të tij të përdorur për transfuzion, mund të parandalojë transmetimin e virusit të hepatitit B. Praktikrat e injeksioneve të sigurta, duke eliminuar injeksionet e panevojshme dhe të pasigurta, mund të jenë strategji efektive për t'u mbrojtur kundër transmetimit të virusit të hepatitit B. Gjithashtu, praktikrat më të sigurta seksuale, përfshirë minimizimin e numrit të partnerëve dhe përdorimin e masave mbrojtëse/prezervativë mbrojnë kundër transmetimit të virusit të hepatitit B.